



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 28.02.2020

**Lënda:** Sqarim për emisionin investigativ “Fiks fare”, në televizionin kombëtar Top Channel datë 25.02.2020.

Të nderuar,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në përgjigje të emisionit investigativ “Fiks Fare” në televizionin kombëtar Top Channel, transmetuar datë 25.02.2020, lidhur me shqetësimet e fermerëve për përfitimin financiar nga masat mbështetëse përmes Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2019, bazuar edhe në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 3/1, datë 15.04.2019 “Për Kriteret, Procedurat dhe Mënyrën e Administrimit të Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural” bën me dije opinionin publik se janë ndjekur me përpikmëri procedurat e mëposhtme:

- Kreu VI. nga Udhëzimi i MBZHR dhe MFE, nr. 3/1, datë 15.04.2019 me titull: Kriteret specifike dhe dokumentacioni i nevojshëm për masat direkte 1- 6, specifikisht: **Masa 1. “Për tufën bazë të matrikulluar, për fermat me jo më pak se 100 krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1000 (njëmijë) lekë/krerë”, si dhe,**
- Kreu VII. Procedura që do të ndiqet për Përzgjedhjen, Verifikimin dhe Pagesat për Masat Mbështetëse me nr.1-6, pika 2. faqe 17 qartëson se: “Me përfundimin e fazës së aplikimit, sistemi gjeneron automatikisht listat e aplikuesëve për çdo masë mbështetëse, sipas parimit “Kush vjen i pari renditet i pari”.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në rolin e saj si agjenci zbatuese, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.128, datë 13.03.2019, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2019, dhe në zbatim të Udhëzimit të MBZHR dhe MFE, nr. 3/1, datë 15.04.2019, përmes pagesave direkte nga AZHBR bën me dije se janë mbështetur në total 4009 fermerë dhe sipërmarrës ruralë, në shumën 798,805,915 lekë.

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**